



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1298/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr. 4, kundër debitorit Sendviq Bar Merys, me seli në Prishtinë, rr. “Qazim Bobaj”, nr. 1, të cilin e përfaqëson Zyra Ligjore “Pro Juris” L.L C., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP, nr.2122/2022 të datës 17.08.2023, me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2122/2022 të datës 17.08.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2122/2022 të datës 17.08.2023, e ka pranuar si të bazuar propësimin e debitorit Sendviq Bar Merys, me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhrin Përmbarimor P.nr.87/21, i lejuar me datë 20.01.2021, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi, e ka Shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovet si e themeltë ankesa e kreditorit, ashtu që aktvendimin KPPP.nr.2122/2022 të datës 17.08.2023 ta prishe dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose ta ndryshoje aktvendimin e kundërshtuar.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori, me propozimin që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e kreditorit, të vërtetohet si i bazuar aktvendimi KPPP.nr.2122/2022 të datës 17.08.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga librat e kontabilitetit me numër 69339, ka lejuar Urdhrin për Përmbareim P.nr. 87/21, të datës 20.01.2021, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit borxhin prej 2,949.56Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbareimit, me arsyetim se propozimi për përmbareim mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk i përmban shënimet e kërkuara dhe numrin identifikues apo të biznesit të debitorit. Më tej, ka theksuar se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, përkatësisht kartela e konsumatorit, nuk parashihet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29 4 të LPP. Në fund, ka theksuar se borxhi i kërkuar nga kreditori është paushall, nuk është pasqyruar gjendja reale e pagesave të debitorit, dhe se i njëjti borxh është përfshi në parashkrim në kuptim të dispozitave të LMD-së, ngase vlera e kërkuar është para vitit 2013. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbareimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara, dhe të pa mbështetura në ligj dhe prova. Në raport me pretendimet për parashkrim të kërkesës, ka theksuar se afati i parashkrimit është ndërpre me datë 16.02.2018, ngase debitori ka kryer pagesë në vlerë prej EUR 8.38. Ndërsa, lidhur me pretendimet se kartela financiare nuk përbën dokument përmbareimit, kreditori ka theksuar se e njëjta kartelë është dokument autentik dhe e përshtatshme për përmbareim ngase Ligji për procedurën përmbaremore e njuh si të tillë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2122/2022 të datës 17.08.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Sendviq Bar Merys, me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhrin Përmbareimor P.nr. 87/21, i lejuar me datë 20.01.2021, nga Përmbareuesi Privat Isa Gacaferi, e ka Shfuqizuar. Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë, thekson se urdhri për lejimin e përmbareimit është marrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngasë në propozimin për përmbareim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbareim përmban të meta në kuptim të nenit 38 par.1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen sepse gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmëria e urdhrit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës

– Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareme me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbareme duhet të anulohet, me arsyen se duke u bazuar me dispozitën e nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *Propozimi për përmbareme duhet ta përmbajë kërkesën për përmbareme në të cilën do të tregohet dokumenti përmbareme origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbaremi, kërkuesi i përmbaremit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbaremi, objekti i përmbaremit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbaremit. 2. Në rast se propozimi për përmbareme nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbareme do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

Prandaj, në këtë rast rezulton se urdhri mbi lejimin e përmbaremit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim për përmbareme kreditori nuk i ka treguar të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht propozimi për përmbareme është ushtruar ndaj Sendviq Bar Merys, me seli në Prishtinë, duke mos treguar të dhënat e tjera të debitorit. Në vlerësimin e gjykatës, vetëm përshtetimi i debitorit “Sendviq Bar Merys, me seli në Prishtinë” pa treguar numrin e biznesit apo identifikues të debitorit, nuk është i mjaftueshëm për identifikimin e saktë të debitorit. Si rezultat i këtyre të metave, propozimi për përmbareme nuk i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së. Andaj, mbi këtë bazë, me nenin 3, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “*Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbaremeshmërisë së nxjerrë nga përmbaremi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbaremit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaremi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbareme nga përmbaremi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim*”. Kjo Gjykate vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbaremit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbareme nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbareme përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur edhe kur ka konstatuar se të metat lidhur me të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit kanë mundur të evitohen nga organi përmbarues, përkatësisht nga përmbaruesi privat, në kuptim të nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, andaj mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk mund të merren për bazë tani pretendimet ankimore sa i përket të plotësimit të dhënave identifikuese të debitorit.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1298/23 datë 02.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha